

## **Juridiksioni Kushtetues kundrejt juridiksonit të zakonshëm**

### *Praktika e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë*

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman IRZ dhe

Asamblenë e Gjyqtareve të EULEX – Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

Seminar mbi "Fushëveprimin e vlerësimit të vendimeve të Gjykatës Supreme"

*Prishtinë - 13 Qershor, 2013*

**Bashkim Dedja**

**Kryetar**

**Gjykata Kushtetuese Shqiptare**

I nderuar Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës,

Të nderuar kolegë gjyqtarë,

Të nderuar të pranishëm,

Fillimisht, dua të shpreh falenderimet e mia në lidhje me këtë ftesë për pjesmarrje në këtë takim të nivelit të lartë mes gjykatave të Republikës së Kosovës. Gjithmonë është kënaqësi bashkëpunimi me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, si një gjykatë e re, e cila ka nevojë për referime në gjykata homologe kushtetuese, për më tepër në gjykata që kanë pasur të njëjtën problematikë dhe mund të ofrojnë eksperiencë të ngjashme.

Aktivitete të përbashkëta si ky i sotmi, edhe ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë së Shqipërisë mbi tematika kushtetuese, janë zhvilluar disa herë ndër vite. Veçanërisht, komunikimi mes Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, jo vetëm nëpërmjet vendimeve përkatëse, mendoj se është një mjet i rëndësishëm, sepse reflekton shqetësimet që gjyqtarët përkatës mund të kenë, por reflekton dhe debatet dhe mirëkuptimet profesionale, të domosdoshme me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit në tërësi, në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në këtë pjesë të referatit tim, do të adresoj raportet mes Gjykatës Kushtetuese Shqiptare (GJK) dhe gjyqësorit të zakonshëm, nismat dhe instrumentet për forcim të kompetencave të GJK si dhe pasqyrimin e disa praktikave më ilustruese në këtë drejtim.

Si fillim, dua të jap një pamje të përgjithshme të pozicionit të GJK, në sistemin kushtetues shqiptar. Detyra për garantimin dhe respektimin e Kushtetutës nga veprimtaria e pushtetit publik i është ngarkuar një organi të specializuar dhe të posaçëm, Gjykatës Kushtetuese. (*modeli kelsenian*). Ajo është instanca e fundit e ngarkuar me kontrollin ndaj akteve të nxjerra nga organet e pushtetit shtetëror, duke u përqendruar në aspektin e pajtueshmërisë së tyre me dispozitat kushtetuese. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Ky detyrim kushtetues i organeve publike mund të përfshijë si organet e administratës shtetërore që i përkasin degës së pushtetit ekzekutiv, ashtu edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese presupozon domosdoshmërisht një sistem ligjor hierarkik, i cili respekton Kushtetutën dhe bën interpretim përfundimtar të saj (neni 124). Juridiksioni kushtetues përfshin të gjitha llojet e konflikteve kushtetuese që kanë rëndësi për rendin kushtetues ose me fjalë të tjera ky juridiksion përcaktohet në atë mënyrë që rendi kushtetues të kontrollohet nga të gjitha aspektet e tij të rëndësishme (neni 131).

Duke iu kthyer temës për të cilën organizohet ky workshop, më konkretisht mund të them se, sipas Kushtetutës së Shqipërisë, juridiksioni kushtetues takohet me veprimtarinë e juridiksionit të zakonshëm në dy tipe të kontrollit kushtetues: **gjykimi incidental** dhe **proces i rregullt ligjor**<sup>1</sup>. Përpjekjet e GJK gjatë shqyrtimit të kërkesave, në këto lloj gjykimesh, kanë qenë të tilla që, të mos merret me zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por të identifikojë faktet e natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues. Por GJK, po gjatë përpjekjeve të saj për gjetjen e fakteve kushtetuese, duke u bazuar në

---

<sup>1</sup> Përveçse dhe rastit kur GJK kontrollon dhe garanton pavarësinë e gjyqësorit, nga ligje në kundërshtim me ndarjen dhe ekuilibrimin e pushteteve, sipas normave kushtetuese.

parimin e vetpërbajtjes, ka theksuar se ajo nuk duhet të ndërhyjë në kompetencat e gjyqësorit të zakonshëm, pasi:

“...Përdorimi i formulës së “të drejtës së gjallë” e ndihmon Gjykatën të përcaktojë raportet me gjyqtarët e zakonshëm në terrenin e interpretimit të së drejtës (e njohur si detyrë që u takon posaçërisht këtyre të fundit) duke marrë në lidhje me këtë një qëndrim vetëkufizues (*self restraint*) në kuptimin që, nëse një e drejtë e tillë e gjallë ekziston, Gjykata e mban parasysh dhe (me disa përjashtime) nuk ndalet të bëjë një interpretim të ndryshëm, edhe atje ku i duket asaj më bindëse”.<sup>2</sup>

## I

### Kontrolli incidental

Kontrolli incidental, zë një vend të posaçëm në kontrollin kushtetues të ligjeve. Për këtë lloj kontrolli GJK vihet në lëvizje nga gjykatat/gjyqtari i zakonshëm. Në nenin 145/2 të Kushtetutës përcaktohet se:

“Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijjnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast ato pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese”.

Sipas ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” (ligji organik i GJK), gjykata, veç vlerësimit se ligji është antikushtetues duhet të sqarojë me kujdes dhe lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Në mënyrë të përmbledhur Gjykata referuese/dërguese<sup>3</sup> që të legjitimohet (*locus standi*) duhet që gjatë procesit gjyqësor:

1. Të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete;
2. Të parashtojë arsye serioze për jokushtetueshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.
3. Të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese dhe se kjo

<sup>2</sup> Vendimi nr.6/2012 i GJK

<sup>3</sup> Këto terma janë përdorur nga vetë GJK.

gjykatë nuk kishte mundësi ta zgjidhte çështjen edhe pa iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

4. Të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*vendimet nr.30/2010; nr.18/2010; nr.12/2010; nr.2/2010; nr.13/2009; nr.5/2009; nr.14/2008; nr.11/2008; nr.3/2008; nr.21/2007; nr.33/2007; nr.3/2006 të GJK dhe nr.142, datë 01.12.2011, i Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

Kushtetuta dhe ligji shprehet qartë se, gjykata që ka identifikuar normën antikushtetuese sipas vlerësimit të saj dhe ka krijuar bindjen se nuk mund ta zgjidhë çështjen pa iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese e pezullon procesin, ndërsa për gjykatat e tjera që kanë të njëjtën bazë ligjore në diskutim për zgjidhjen e çështjes gjyqësore hesht. Asnjë përcaktim ligjor nuk ka për këtë çështje edhe në Kodet e Procedurave Penale<sup>4</sup> apo Civile<sup>5</sup>, pra nuk ka dispozita konkrete që të trajtojnë posaçërisht situatën.

Në këtë aspekt, ka lindur pyetja: C'farë duhet të bëjnë gjykatat e zakonshme, duhet ta pezullojnë procesin? Cili është efekti i një vendimi për kalimin e çështjes në shqyrtim nga GJK, për gjykatat e tjera?

Kushtetuta nuk është shprehur lidhur me procedurat që duhet të ndiqen nga GJK, me ardhjen e vendimit të pezullimit nga gjykatat e zakonshme, por ligji organik i GjK-së, neni 70/1 përcakton se:

“Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të çështjeve të parashikuara nga neni 68<sup>6</sup>, 69<sup>7</sup>, të këtij ligji dhe për arsye që kanë të bëjnë me antikushtetutshmërinë e një ligji konkret, *publikon faktin se çështja është nën shqyrtimin e saj.*”

<sup>4</sup>Neni 343 i K.Pr.Penale përcakton se kur përfundimi i një çështje penale varet nga zgjidhja e mosmarrëveshjeje civile apo administrative për të cilën zhvillohet një gjykim, gjykata mund të vendosë pezullimin e shqyrtimit gjyqësor derisa çështja të zgjidhet me vendim të formës së prerë.

<sup>5</sup>Neni 297 i K.Pr.Civile përcakton se gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile, ose administrative;.....

<sup>6</sup>1. Kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit.

Ndërkohë në nenin 26 (Publikimi i vendimit përfundimtar), të po këtij ligji, përcaktohet se:

“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare. Ato botohen në Fletoren Zyrtare dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit të saj. Kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij. Organi që boton Fletoren Zyrtare detyrohet të bëjë botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 15 ditë nga ardhja për botim e tyre pranë atij organi...”.

Sipas kësaj dispozite, lexohet qartë domosdoshmëria e botimit në Fletore Zyrtare të vendimeve përfundimtare të GjK-së , por nuk del se fakti i shqyrtimit të çështjes nga GjK me kontroll incidental duhet botuar në Fletore Zyrtare siç referon neni 70/1 i sipërcituar.

Në websitin e Gjykatës Kushtetuese në rubrikën e njoftimeve, vendoset njoftimi lidhur me kërkesat e ardhura nga gjykatat e zakonshme<sup>8</sup>. Kjo praktikë e ndjekur nuk zevëndëson dhe nuk zgjidh çështjen e efekteve të dërgimit të një ligji në GjK si antikushtetues. Me fjalë të tjera, në këtë rast gjyqtarët/gjykatat me marrjen dijeni të procesit të filluar në GjK si kontroll incidental i normës juridike, nëse nuk e çmojnë ligjin antikushtetues (sipas bindjes së tyre të brendshme) mund ta zgjidhin çështjen në shqyrtim me të njëjtën bazë ligjore për të cilën është vënë në lëvizje GjK dhe që po shqyrtohet për antikushtetushmëri.

---

2. Në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat konkrete ose parimet e tjera të Kushtetutës, të cilat ligji nuk i ka respektuar ose i ka cenuar, si dhe shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i tij.

<sup>7</sup>1. Gjykata Kushtetuese, kur konstaton se çështja nuk është e plotë dhe në përputhje me nenin 68 të këtij ligji, ia kthen atë gjykatës që e ka dërguar. Kjo e fundit detyrohet të plotësojë materialet brenda 1 muaji nga data e mbërritjes.

2. Kur materialet e dosjes janë të plota dhe në përputhje me nenin 68, Gjykata Kushtetuese cakton datën e seancës për shqyrtimin e çështjes, duke njoftuar gjykatën dhe thirrur subjektet e interesuara.

<sup>8</sup>**Shembull njoftimi marrë nga websiti i gjykatës:** [Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 70/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizmin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” njofton se është nën shqyrtimin e saj kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt: "Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën i paragrafëve VII dhe VIII të nenit 34 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë"].

Por edhe më pas, me shfuqizimin e një dispozite apo ligji si antikushtetues, nuk mbyllet çështja për gjykatën e juridiksionit të zakonshëm, pasi ajo ndodhet përsëri para disa pengesave ligjore për të përfunduar çështjen që ka për gjykim. Si gjykata që ka dërguar çështjen në GJK edhe gjykatat e tjera që kanë në shqyrtim çështje me të njëjtën bazë ligjore, ndodhen para dy vështirësive; së *pari* nëse dispozita është shpallur antikushtetuese me vendim të GJK-së, por që i ka dhënë efekte të mëvonshme këtij vendimi (*pro futuro*), gjykatat ose duhet të presin hyrjen në fuqi të vendimit, ose të vazhdojnë zgjidhjen e çështjes me ligjin në fuqi edhe pse antikushtetues; së *dyti* me shfuqizimin e ligjit dhe me hyrjen në fuqi të vendimit të GJK-së krijohet boshllëk ligjor, gjykatat janë të detyruara të presin deri sa, organi ligjvënës të bëjë plotësimet që lidhen drejtpërsëdrejti me gjykimin dhe të lënë pezull shqyrtimin gjyqësor pa afat deri në plotësimin e dispozitës. Mendoj se, në këtë rast dhe sidomos, kur ka vonesa të tejzgjatura apo Kuvendi nuk e ka bërë plotësimin brenda afatit të caktuar në vendimin e GJK-së, atëherë, gjykatat duke vlerësuar edhe ngutshmërinë e çështjes duhet të gjejnë mënyrat alternative për zgjidhjen e saj. Ato mund të përdorin me interpretim dispozita të ngjashme jo penale, të përdorin analogjinë në rastet kur është e mundur, apo ta zgjidhin çështjen referuar drejtpërsëdrejti Kushtetutës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës.

Si përfundim, Gjykatat (*përjashtojë gjykatën që ka paraqitur çështjen, e cila bën pezullimin me nenin 145/2 të Kushtetutës si normë procedurale*) nuk mund ta pezullojnë procesin të paktën detyrimisht sa rezulton nga kuadri juridik, por për më tepër mendoj se, nuk mund ta vazhdojnë zgjidhjen e çështjes me një normë të vënë në diskutim si antikushtetuese. Në të kundërt, do të krijonin situata shkeljesh kushtetuese të të drejtave të individëve, në drejtim të parimit të sigurisë juridike, dhe mosdiskriminimit. Gjithsesi kjo është një çështje që ligji organik i GJK, shpresojmë ta rregullojë më mirë (me ndryshimet në proces), sidomos pjesën e efekteve të vendimmarrjes së GJK-së, në kontrollet incidentale, duke shmangur dhe debate dhe konfliktualitete juridike të panevojshme.

## II

### Procesi i rregullt ligjor

Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese është e lidhur me kontrollin e procesit të rregullt ligjor, e drejtë procedurale kushtetuese. Gjatë kontrollit kushtetues të procesit të rregullt ligjor, sigurisht që Gjykata Kushtetuese ndodhet para diskutimeve mbi efektet e vendimmarrjes së saj, dhe impaktit që ato do kenë specifikisht në punën e gjyqësorit të zakonshëm. *Lidhja funksionale* mes këtyre gjykatave, që ka të bëjë me detyrueshmërinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, efektet e këtyre vendimeve për gjyqësorin e zakonshëm, e bën Gjykatën Kushtetuese, që të jetë e kujdesshme në mënyrën e marrjes së vendimit, formulimit dhe efekteve praktike të tij.

GJK ndër vite e ka zgjeruar konceptin e të drejtave të individit dhe së drejtës së tij për t'u ankuar në përputhje me standardet e GJEDNJ-së. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka zgjeruar hapësirat e individit, duke e interpretuar legjitimitimin maksimalisht në favor të aksesit në gjykatë. Individit mund t'i drejtohet kësaj gjykate jo vetëm kur ka ezauruar të gjitha shkallët e gjykimit, por edhe kur ndjekja e procedurave të ankimit do të rezultonte me tejzgjatje të shkeljes ose një rëndim të mëtejshëm të situatës. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se mund të merren në shqyrtim nga kjo gjykatë edhe kërkesat e individëve, për cenimin e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre mund të mos ketë përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm<sup>9</sup>. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre. Fakti që autoritetet shtetërore zbatojnë vendimin, *pas një vonese thelbësore*, nuk mund të konsiderohet se i heq automatikisht kërkuarit statusin e personit, të cilit i është cenuar një e drejtë, në kuptimin kushtetues.<sup>10</sup>

*De facto* Gjykata Kushtetuese mbetet një mjet ankimi jo efektiv lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga organet e administratës publike, si dhe me kohëzgjatjen e paarsyeshme të gjykimeve si elementë të procesit të rregullt ligjor në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, ndërsa

<sup>9</sup> Vendimi nr.12/2012

<sup>10</sup>Vendimi nr. 8/2010 i GJK

në elementët e tjerë të tij, GJK shfuqizon vendimin e gjykatave të zakonshme (dhe jo konstaton), çështja rikthehet për rigjykim, duke ofruar ndreqje të pasojave dhe korigjim të shkëljes brenda sistemit ligjor shqiptar. Prandaj dhe lidhur me kohëzgjatjen, GJK ka bërë propozime për ndryshim të ligjit organik të GJK, dhe forcim të kompetencave në këtë drejtim, duke i dhënë kompetencën për vënie afati gjykatave, ku ka ngecur çështja për mbarimin e saj dhe duke i ofruar dëmshpërblim individëve që ankohen në lidhje me këtë shkëlje. Po kështu dhe në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, edhe pse ligji organik parashikon vënien e një gjobe prej 100.000 lekë nga Kryetari i Gjykatës, për mosekzekutimin e vendimeve të vetë GJK, kjo dispozitë duket e pamjaftueshme dhe e papërshtashme, prandaj dhe GJK në këto raste duhet të bëhet më efektive duke i dhënë kompensim individit që ka vuajtur pasojat negative në pritje të gëzimit të drejtës së fituar gjyqësisht.

Po kështu, kjo gjykatë ka pranuar se, kur kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit, dhe kur karakteri i *vendimit të ndërmjetëm* e kërkon, si përjashtim, ai mund të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131/f të Kushtetutës, duke i hapur rrugë kontrollit kushtetues të kësaj kategorie vendimesh<sup>11</sup>. Në këtë kontekst, kjo gjykatë, ka pranuar vendimet e ndërmjetme të masave të sigurimit, si përfundimtare, duke i kontrolluar për proces të parregullt ligjor, si dhe vendimet e fazës së parë të pjestimit të pasurisë, mbi pjesët takuese të bashkëpronarëve.

Në pothuajse të gjitha rastet, ankimet e individëve drejtohen kundër vendimeve të gjykatave të zakonshme dhe për këtë arsye GJK përballet jo rrallë me domosdoshmërinë e përcaktimit të kufijve ndarës midis kontrollit që duhet të ushtrojë ajo dhe kontrollit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ka patur raste, kur GJK akuzohet për ndërhyrje në pavarësinë e gjykatave, më së shumti të Gjykatës së Lartë, duke e cilësuar atë si gjykatë të shkallës së katërt.

Për interes të auditorit, do prezantoj dy praktika që kanë krijuar konflikt mes GjK dhe Gjykatës së Lartë, një ka qenë në lidhje me qëndrimin mbi gjykimin në mungesë dhe mbrojtjen e të pandehurit tç caktuar nga familjarët e të gjykuarit në mungesë dhe

---

<sup>11</sup> Vendimi nr.28/2011



tjetra ekzekutim i vendimit të GJEDNJ-së nga Gjykata e Lartë, duke detyruar këtë gjykatë të pranojë vendimin e GJEDNJ, si arsye rishikimi.

Në rastin e parë, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.17, datë 17.04.2000, kishte vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimit Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin për shqyrtim të çështjes po kësaj gjykate. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kishin cënuar të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet mohimit të të drejtës për t'u mbrojtur dhe të drejtës për gjykim, të garantuara në nenet 31, shkronja "c" dhe 42 të Kushtetutës, si dhe në nenin 6 të KEDNJ.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe pavarësisht nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i qëndruan mënyrës së mëparshme të interpretimit të normave procedurale-penale në bazë të vendimit të tyre, të shfuqizuar nga GJK, duke konkluduar përfundimisht se *“mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata ose i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykimin që zhvillohet në mungesë të të pandehurit për të mbrojtur interesat e tij, nuk është person i legjitimuar për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit”*. Gjithashtu, ato kishin arritur në përfundimin se, *“procesi i gjykimit të kësaj çështjeje (në Gjykatën e Lartë) është zhvilluar rregullisht”*.

Cështja erdhi përsëri në GJK dhe kjo Gjykatë ripërsëriti qëndrimin dhe i vuri theksin autoritetit të saj si interpretues përfundimtar i Kushtetutës dhe detyrueshmërisë së zbatimit të vendimeve, (vendimi nr.5/2001)<sup>12</sup>.

Në rastin e dytë, (vendimi nr.20/2011), kërkuesi i ishte drejtuar GJEDNJ, e cila kishte vërejtur se vendimi i pushimit të çështjes, dhënë me vendimin e datës 14.12.1998 ndaj aplikantit kishte marrë formë të prerë më 24.12.1998. Kërkesa e prokurorit për të apeluar jashtë afatit ligjor vendimin e pafajësisë dhe pranimit të kësaj kërkesë, duke i dhënë të drejtë prokurorit për rivendosje në afat të ankimit, kishte sjellë shkeljen nga Gjykata e Lartë të parimit të sigurisë juridike, e cila kishte prishur vendimin e pushimit dhe e kishte deklaruar fajtor.

<sup>12</sup>Shih dhe vendimin nr.30/2010 të GJK, ku u ridimensua qëndrimi i kësaj gjykate në lidhje me gjykimin në mungesë.

Sipas GJEDNJ, mënyra e duhur për rivënien në vend të të drejtës së shkelur të aplikantit do të ishte rikonfirmimi nga autoritetet përkatëse i vendimit të 14 dhjetorit 1998, ku ishte vendosur pranimi i kërkesës së kërkuarit dhe pushimi i çështjes, sepse ai nuk e kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej.

Pas dhënies së vendimit nga GJEDNJ-ja, me datë 06.01.2010 kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar pavlefshmërinë e vendimit nr.417, datë 20.06.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së të datës 29.07.2008. Në këtë kuadër, ai i kishte kërkuar GJK njohjen e pafajësisë për veprën penale të vrasjes dhe ekzekutim të vendimit të GJEDNJ.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 22, datë 09.03.2010, vendosi mospranimin e kërkesës, duke përcaktuar se organi shtetëror kompetent për të përmbushur detyrimet që rridhnin nga vendimi i sipërpërmendur i GJEDNJ-së ishte Gjykata e Lartë.

Me vendimin nr. 1042, datë 09.07.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi mori në shqyrtim çështjen vendosi mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 417, datë 20.06.2001 të Gjykatës së Lartë. Sipas saj, vendimet e GJEDNJ-së nuk ishin të barasvlershme me vendimet e gjykatave shqiptare.

GJK e mori përsëri në shqyrtim çështjen pas kërkesës së aplikantit, dhe arriti në përfundimin se, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që kishte vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit nr.417, datë 20.06.2001 të Kolegjit Penal të kësaj gjykate, vinte në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ, prandaj dhe e shfuqizoi. Në raport me efektin e vendimeve të GJEDNJ në sistemin e brendshëm ligjor shqiptar, kjo çështje u konsiderua novatore, sepse Gjykata Kushtetuese, detyroi GJK të rihapë proceset penale të përfunduara me vendim të formës së prerë, pas dhënies së një vendimi nga GJEDNJ.<sup>13</sup>

---

<sup>13</sup> Vendimi nr.20/2011

Një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, mbetet paanësia e gjykatave, që sikundër konstatova nga materialet mbështetëse, të ftesës për të marrë pjesë në këtë workshop, ishte bërë objekt debati, për më tepër në media lokale dhe në Kosovë në lidhje me gjykimin e një funksionari publik të njohur nga Gjykata e Lartë dhe pastaj nga ajo Kushtetuese.

Në lidhje me paanësinë, GJK ka theksuar, se është e një rëndësie themelore në një shoqëri demokratike që gjykatat të frymëzojnë besim te publiku dhe, mbi të gjitha, te palët në proces. Për këtë qëllim neni 42 i Kushtetutës kërkon që një gjykatë, e cila përfshihet në sferën e veprimit të tij, të jetë e paanshme. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjytimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet, duke zbatuar testin objektiv me të cilin shqyrtohet, nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë dhe testin subjektiv që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose të interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar (*vendimet nr.7, datë 11.03.2008; nr.11, datë 02.04.2008; nr.23, datë 04.11.2008*). Nga pikëpamja e testit objektiv të paanshmërisë, kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm. (*vendimi nr.10, datë 02.04.2009*).

GJK ka theksuar se jo gjithmonë pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në shkallët të ndryshme gjykimi përbën cënim të paanësisë. (*vendimi nr.9/2006*). Çështja e pjesëmarrjes së të njëjtin gjyqtar në të njëjtat procese gjyqësore ka shqetësuar shpesh GJK, dhe asaj i është dashur të analizojë rolin e gjyqtarëve përkatës në secilën prej trupave vendimmarrëse dhe efektet në vendimmarrjet konkrete.

P.sh. në rastin kur të njëjtët gjyqtarë marrin pjesë dhe në *Dhomë Këshillimi* ku kanë vlerësuar ekzistencën e shkaqeve për të rishikuar vendimin gjyqësor penal të formës së prerë, dhe në procesin e parë, ku në *seancë gjyqësore* kanë vlerësuar respektimin ose zbatimin e drejtë të ligjit procedural dhe material. Gjyqtarët e pranishëm në Kolegjin Penal, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim nuk kanë gjykuar drejtësinë e një vendimi të mëparshëm të dhënë prej tyre, por kanë vlerësuar ekzistencën e një prove të pretenduar si të re nga kërkuesi, e cila nuk dihej në kohën e gjykimit. GJK vlerësoi se në këtë proces dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë në Dhomë Këshillimi kanë vlerësuar ekzistencën e një prej rasteve të parashikuara nga neni 450 i K.Pr.Penale. Duke qenë kështu, pretendimi për anësinë e gjyqtarëve është i pabazuar, sepse nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i justifikueshëm mbi anësinë e tyre. (*vendimi nr.25/2011, por me mendim pakice 5 me 4*). Me vendimin nr.7/2011, gjyqtarët kanë pas mbajtur qëndrimin se përbën cënim, qënia e të njëjtëve gjyqtarë edhe në kërkesën për rishikim edhe në rekurs.

Në një rast tjetër, kur i njëjti gjyqtar ka qenë dy herë relator në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, për GJK kjo përbente cënim të parimit. (*vendimi nr.17/2007*). Ndërsa kur gjyqtarë që kanë gjykuar në Kolegj, kanë marrë pjesë në vlerësimin e masës së arrestit, ndaj kërkuesit, për GJK nuk përbente cënim të paanësisë (*vendimi nr.9/2006*).

GJK për të arritur në konkluzionin se gjyqtari ka qenë i anshëm gjatë procesit, ka bërë edhe dallimin mes roleve që ky i fundit ka patur si gjyqtar i atij trupi gjykues gjatë gjykimit. P.sh kur një gjyqtar ka marrë pjesë në seancën e vërtetimit të faktit të pronësisë dhe më pas ka qenë anëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, lidhur me këtë pronë, për GJK nuk përbën cënim të paanësisë (*vendimi nr.22/2011*).

Ndërsa kohët e fundit, GJK në lidhje me mosrespektimin e standardit të arsytimit të vendimeve, ka shfuqizuar dy vendime të Gjykatës së Lartë, sepse, në formë ishin të parregullta. Nga formati i vendimit të mospranimit të rekursit nuk evidentoheshin, se cilat ishin pretendimet e kërkuesit. Sipas gjykatës, kjo mungesë krijonte dyshime mbi vetë dhënien përgjigje të këtyre shkaqeve, duke cenuar të drejtën e aksesit efektiv të kërkuesit. (*Vendimi nr.9/2013; nr. 22/2013*).

Pretendimet në GJK nga individët janë të ndryshme, duke filluar nga marrja e provave, vlerësimi i provave, keqzbatimi dhe interpretimi i ligjit, interpretimi i Kushtetutës. Jo të gjitha kërkesat shprehin mjaftueshëm lëndë kushtetuese dhe njohuri mbi kontrollin kushtetues të procesit nga GJK. Gjithsesi për shkak të detyrimit që GJK ka për t'iu përgjigjur pretendimeve kryesore të individit, i është dashur që shpesh të konfirmojë deri diku dyshimin e individit për shkelje të ligjit, por duke i bërë të ditur atij, se jo çdo shkelje është e nivelit kushtetues. Edhe pse këto shkelje mund të cenojnë të drejtat themelore të individit, Kushtetuta ka parashikuar të tjera gjykata për t'i mënjeluar ato. Kështu Gjykata Kushtetuese është shprehur në vazhdimësi se:

“...pretendimin për marrje provash në mënyrë të paligjshme e konsideron të lidhur me parimet që u referohen provave. Sipas këtyre parimeve, vlerësimi i provave, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor. (vendimi nr.42, datë 18.12.2007; nr.1, datë 12.01.2007; nr.7, datë 28.2.2000)

Ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata ka vlerësuar se, jo çdo lloj shkeljeje në këtë drejtim e bën tërësisht procesin gjyqësor të parregullt, pasi procesi duhet të vlerësohet në tërësinë e ecurisë së tij. P.sh. në një çështje edhe pse mënyra e marrjes së dëshmisë nga dëshmitarë minorenë pa praninë e kujdestarit apo prindërve në përputhje me procedurat penale të marrjes së dëshmisë, GJK nuk e konsideroi procesin të parregullt, sepse sipas saj kjo shkelje procedurale nuk do ia ndryshonte rrjedhën rezultatit final. (vendimi nr.42/2007)

Po sipas GJK, gjykatat kanë për detyrë të çmojnë kërkesat e palëve në proces, si p.sh. përsëritje të shqyrtimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit, kërkesa për thirrje dëshmitarësh, kërkesa për bërje ekspertize, etj, por nuk janë të detyruara t'i pranojnë *a priori*, por, pasi të kenë dëgjuar pretendimet e palëve, duhet t'u japë përgjigje atyre me vendim. (Vendimi nr.42, datë 18.12.2007; vendimi 90, datë 25.7.2001).

Gjithashtu, edhe në rastet kur asaj i është kërkuar rivlerësimi i disa fakteve dhe provave, mbi të cilat është mbështetur gjykata e zakonshme për marrjen e vendimit

të kundërshtuar para GJK në shkelje të standardit “gjykatë e caktuar me ligj”, ajo ka argumentuar se:

“...bërja e një analize apo vlerësimi të ri nga ana e Gjykatës Kushtetuese të një prove të administruar në dosjen gjyqësore, që në rastin konkret lidhet me aktekspertimin e vlerës së objektit të padisë dhe të kundërpadisë, do ta deformonte procesin kushtetues dhe do ta shndërronte atë në një proces gjykimi të zakonshëm. Mbi këtë analizë, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuuesi nuk provon se procesi gjyqësor ka qenë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese...Përcaktimi me saktësi ...i vlerës së padisë dhe të kundërpadisë ... është një çështje të provuari që nuk mund të rivlerësohet nga Gjykata Kushtetuese. Të dy gjykatat, në vendimet e tyre, e kanë analizuar këtë pretendim të kërkuessit duke i dhënë përgjigje se vlera e padisë dhe e kundërpadisë nuk e kalon kufirin ligjor të përcaktuar me ligj”.<sup>14</sup>

Edhe shkelje e të drejtave themelore që vijnë si pasojë e interpretimeve të ndryshme të ligjit apo nga mangësi të zakonshme ligjore, sipas GJK janë konceptuar si kompetencë e gjyqësorit të zakonshëm dhe më konkretisht e Gjykatës së Lartë, e cila në Dhomë Këshillimi vendos për kalimin e çështjes në seancë apo jo. Sipas, GJK, Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t’u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraeliminators të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sigurisht që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund t’ia deformojë funksionin vlerësues dhomës së këshillimit. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. (Vendimi nr.22, datë 06.06.2011).

---

<sup>14</sup> Vendim i GJK nr.28/2005.

GJK nuk merr përsipër të dublojë funksionin e gjyqësorit, duke rishikuar edhe një herë interpretimin e së drejtës së zakonshme nga gjykatat apo vlerësimin e provave nga ana e tyre. GJK ka treguar vetëpërmbytje sa i takon shqyrtimit të pretendimeve të kërkuarit që lidhen me vlerësimin e provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, apo interpretimin e ligjit. Sipas saj, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, pretendimet e parashtruara si në Gjykatën e Lartë ashtu edhe në GJK janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme. Ajo është shprehur se:

“...kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj”.<sup>15</sup>

### III

#### ***Disa vlerësime në lidhje me vendimet unifikuese***

Një çështje që prek juridiksioni kushtetues, janë dhe vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë. Këto vendime e kanë implikuar kontrollin kushtetues si në lidhje me procesin e rregullt ligjor edhe me kontrollin incidental, prandaj dhe GJK është ndalur disa herë në qëndrimet e saj në lidhje me to.

Sipas GJK, Kushtetuta i ka njohur Gjykatës së Lartë të drejtën të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore (neni 141/2). Kjo realizohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, pasi gjyqtarët/gjykatat e tjera që vendosin për raste identike/të ngjashme ose vetë Kolegjet e kësaj gjykate nuk mund të vijnë në përfundime të

---

<sup>15</sup>Vendimi nr.41/2005

ndryshme nga ato në të cilat ka arritur Gjykata e Lartë. Detyrueshmëria për zbatimin e këtyre vendimeve parashikohet edhe në nenin 32/f të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit “moszbatimi i vendimit unifikues, (...) të Gjykatës së Lartë, (...) përbën shkelje që diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit”<sup>16</sup>.

Në lidhje me **vlerën e tyre**, GJK është shprehur se:

“... interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Sa më sipër vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t’u përmbahen”.

Ndërsa për **raportet hierarkike** ajo është shprehur se:

“Në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës. Bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, marrëdhëniet midis normave juridike bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlershmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*vendimi nr.3/2006; vendimi nr.2/2010*)”.

---

<sup>16</sup> *Vendimi nr.38/2012*



Sa i përket raporteve **mes ligjeve dhe vendimeve unifikuese**, GJK ka çmuar se:

“Gjykata konfirmon qëndrimin e saj se një çështje nuk hyn në sferën e kompetencës së Gjykatës nëse paraqet probleme të veprimit të ligjit në kohë (siç është rasti në shqyrtim) apo kërkon vlerësime lidhur me vendosjen respektive hierarkike të normave në konflikt, të cilat si të tilla hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatës referuese”.(vendimi nr.6/2012).

GJK po në vendimin në fjalë, ka vlerësuar se nuk i përket juridiksionit kushtetues të vlerësojë hierarkinë e normave ligjore në konflikt, pra normave ligjore dhe atyre të interpretuara me vendim unifikues, sipas pretendimeve të gjykatës referuese.

Ndërsa në lidhje me kontrollin dhe shfuqizimin e vendimeve unifikuese, GJK ka mbajtur qëndrimin se ato mund të shfuqizohen, për sa kohë goditen nga individët, që kanë qenë pjesë e atij procesi gjyqësor, që ka shërbyer për tërheqje në Kolegje dhe unifikim praktike (vendimi nr.5/2001).

Në një çështje tjetër, ku GJK në mosrespektim të vendimit të saj unifikues, kishte vendosur mospranim të kërkesës në Kolegj, GJK konstatoi se interpretimi jo i drejtë i dispozitave procedurale civile në lidhje me afatet e kërkesës për rishkim, kishte lidhje të drejtpërdrejtë me standardet kushtetuese që lidhen me procesin e rregullt ligjor, dhe i kishin mohuar kërkuarit të drejtën e aksesit për t’iu drejtuar gjykatës.

Sipas GJK, në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, neni 445 i KPC-së duhet të zbatohet në harmoni me nenin 496 të KPC-së për sa i përket afatit prekluziv një vjeçar për pasojë, paraqitja e kërkesës tej këtij afati e bën atë të papranueshme. Pra, ky afat llogaritet ose nga momenti që është shpallur vendimi që ankimohet ose nga momenti që merr formë të prerë vendimi që përmban shkakun e rishikimit të parashikuar nga neni 494 i KPC-së, por brenda 30 ditëve të marrjes dijeni. Nëse nuk do të interpretohej në këtë mënyrë, neni 445 i KPC-së ashtu si është shkruar do të ishte i paaplikueshëm, duke ia ngushtuar hapësirat individit për të pasur akses në gjykatë dhe për të shfrytëzuar mjetin procedural të jashtëzakonshëm të kërkesës për rishikim. (Vendimi nr.20/2008)

Gjk me këtë vendim kontrollon procesin e zhvilluar nga GJL për refuzimin e kërkesës për rishikim, duke i treguar Gjykatës së Lartë, që në interpretim të Kushtetutës, por edhe bazuar në vendimin unifikues të dalë prej saj, kërkuarit i ishte mohuar aksesimi, duke mos i pranuar kërkesën për rishikim, edhe pse ishte brenda afatit 30 ditor të nga marrja formë të prerë e vendimit, i cili kishte vërtetuar rrethanën e fallsifikimit (neni 496) dhe brenda 1 viti nga lindja e shkakut të rishikimit, pra nga vendimi i formës së prerë që përmbante shkakun e rishikimit,

#### **IV**

#### **Konkluzione**

Në përfundim, mund të them se, sigurisht çështja e juridiksionit kushtetues nuk është e lehtë, qëndrime kritike mbi praktikën e GJK në këtë drejtim ka patur. Edhe pse Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka një jurisprudencë më shumë se 20 vjeçare, diskutime mbi juridiksionin dhe vetëpërmbajtjen e saj, sjellin vështirësi, herë pas here mbi llojin e vendimmarrjes dhe efektet e vendimit, sidomos për gjyqësorin e zakonshëm. Interpretimi përfundimtar i Kushtetutës, si funksion kryesor i kësaj gjykate, e vë gjykatën në pozitën kushtetuese sa komode por dhe të vetëdijshme për rolin që ka. Në këtë kontekst, mendoj se ajo duhet të mos jetë e tërhequr, në çështje të caktuara gjithmonë në interes të mbrojtjes dhe respektimit të Kushtetutës, ashtu si duhet edhe të tregojë kujdesin e duhur në lidhje me respektimin e ndarjes së pushteteve, së pari nga vetë ajo. Për më tepër, duke ju referuar koncepteve kushtetuese mbi funksionet dhe kufijtë e pushteteve të secilit organ, Gjykata Kushtetuese, me vendimet që merr nuk ka pse të shmangë asnjë organ kushtetues në ushtrimin normal të kompetencave, aq më tepër Gjykatën e Lartë.

Me këtë prezantim, shpresoj të kem dhënë mjaftueshëm jurisprudencë të GJK dhe një pamje të thelluar të pikave të takimit mes GJK dhe gjyqësorit të zakonshëm, por që mund të kenë përfaqësuar dhe një lloj problematike të caktuar, disi dhe konfliktuale mes dy institucioneve.

Ju faleminderit për vëmendjen!